

anin e gjyshit Muhametit. Nga vendi ky ishte, ai i ka parë tanket dhe helikopterët. Muhamedi dhe i biri Naseri i kapën armët dhe hipën në kullën [kati i fundit i shtëpisë së Muhametit]. Rezistonin derisa nuk u vranë. Më vonë, Iliri vërejti se erdhi një kamion, në të cilin policia i ngarkoi trupat e gjyshit dhe axhës së tij. Më pas, kamioni shkoi në drejtim të Likoshanit/Likošane. Në datën 2.03.1998, Kadriu i ka marr trupat e të atit dhe të vëllait nga morgu i spitalit të Prishtinës/Priština. Muhamedi dhe Naseri u varrosën në varrezat e Likoshanit/Likošane më 3.03.1998, së bashku më të gjithë të tjerë të vrarë dhe të rënë në betejë me forcat serbe më 28.02.1998.

Burimet: deklarata S.G, FDH-15623; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; KMKKRFJ, *Personal...*, FDH-10832.

Abide (Sylejman Hetemi)

Ramadani

(1942, shqiptare nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, shtatë fëmijë)

Gjatë sulmit të forcave serbe mbi fshatin Likoshan/Likošane më **28.02.1998**. [të shikohen regjistrimet], Abidja me burrin Ramadanin, vajzat dhe djemtë ishin shtrirë në dyshemenë e shtëpisë së vet në Qirez/Ćirez. E kanë dëgjuar zhurmën e helikopterit që fluturonte drejt Likoshanit/Likošane dhe kur kthehej nga ky fshat. Po ashtu, i dëgjuan të shtënat kur nga helikopteri hapën zjarr mbi shkollë, e cila ishte afro 300 metra larg shtëpisë së tyre në **Qirez/Ćirez**. Nga ora 13:30, Abidja doli në oborr për të mbushur ujë nga bunari. Përderisa e tërhiqte kovën me ujë, u qëllua me një plumb. Ramadani vërejti kur ajo u rrëzua. Doli dhe e barti në shtëpi. Plumbi e kishte qëlluar në kokë. Së shpejti u alivanos. Në ditët e ardhshme, kohë pas kohe i kthehej vetëdija. Fshati ishte i rrethuar me policët serbë për disa ditë rresht. Ramadani ka kërkuar leje nga policia që ta çonte bashkëshorten në spital, por pa sukses. Në datën 12.03.1998, Ramadani e ka huazuar qerren dhe kalin

dhe përmes pyjeve e ka bartur Abiden në spitalin e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica. U kthye më 16.03.1998 me trupin e pajetë të Abides të shtrirë në qerre. Në të njëjtën ditë, familjarët e kanë varrosur Abiden në varrezat e fshatit. Për shkak të pranisë së madhe të policisë serbe, pak kush nga vendasit mori guxim që të merret pjesë në varrim.

Burimet: deklarata S.R, FDH-40655; J. Osmani, *Krimet...*, II, 305.

Iba (Tahir) Rama

(13.07.1961, shqiptar nga Qirezi/Ćirez, komuna e Skënderajt/Srbica, katër fëmijë)

Smajl (Behram) Behrami

(6.07.1970, shqiptar nga Baksi/Baks, komuna e Skënderajt/Srbica, i pamartuar, student)

Në mëngjesin e datës **28.02.1998**, Iba Rama, së bashku me Liman Ademin, si zakonisht gjendej në qendër të Qirezit/Ćirez, ku fitonte nga shitja e cigareve në rrugë. Për dallim nga ditët tjera, kësaj radhe ishin të shqetësuar me breshëritë e të shtënave që u dëgjoheshin nga drejtimi i Likoshanit/Likošane dhe *Mëhalla Prekaz* në **Qirez/Ćirez**. Rreth orës 15:00, pranë tyre kaluan katër makina policore të tipit *Niva*. Dy prej tyre u ndalën papritmas. Nga makinat e ndalura dolën katër policë dhe me sharjet u urdhëruan të shtriheshin në tokë. Pastaj i futën në bagazhin e njëres prej veturave. Aty ishte Smajli nga fshati Baks. Pas pak, policët e nxorën jashtë Limanin për shkak të mungesës së vendit në makinë. E vazhduan rrugën vetëm me Ibën dhe Smajlin.

Smajli ka qenë djalë hasreti. Në mëngjesin e datës 28.02.1998, ai ishte duke e riparuar gardhin e oborrit. Rreth orës 11:00, u nis në pyll për ca drurë që i nevojiteshin për punë. Familjarët e tij, vetëm ditën e nesërme, kanë mësuar se policët serbë kanë hasur aksidentalisht në Smajlin gjatë kalimit nëpër fshat dhe se e kanë futur në makinën e tyre që shkoi drejt Qirezit/Ćirez.

Një ditë më vonë, më 1.03.1998, familjet Behrami dhe Rama kanë mësuar se Ibën dhe Smajlin i kishin vrarë dhe se gjendeshin në morgun e Prishtinës/Priština. Në datën